



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

U R D H Ë R

Nr. 75, datë 11.6.2025

P Ë R

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS
PËR RISHIKIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË KËRKIM-SHPËTIMIT
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT TË TIJ**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Planit Kombëtar për Shërbimin e Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe planit të veprimit të tij.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga zëvendësministri i Mbrojtjes dhe në përbërje të ketë përfaqësues të nivelit drejtues apo persona të autorizuar prej tyre nga këto institucione:

- a) Ministria e Mbrojtjes;
- b) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- c) Ministria e Brendshme;
- ç) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- d) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- dh) Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- e) Qendra e Bashkuar Operacionale;
- ë) Komanda e Forcës Tokësore;
- f) Komanda e Forcës Detare;
- g) Komanda e Forcës Ajrore;
- gj) Komanda Mbështetëse;
- h) Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit;

- i) Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare;
- j) Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- k) Departamenti për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- l) Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- ll) Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në Ministrinë e Brendshme;
- m) Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- n) *Albcontrol-i*;
- nj) Drejtoria e Navigimit Ajror, në Autoritetin e Aviacionit Civil;
- o) Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit, në Aviacionin Civil;
- p) Urgjenca Kombëtare Mjekësore, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- q) Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
- r) Kryqi i Kuq Shqiptar;
- rr) Qendra Vullnetare e Emergjencave Civile.

3. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës mund të ftojë në takime edhe ekspertë të tjerë, vendas apo të huaj, të cilët mund të japin kontributin e tyre për hartimin e Projektplanit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe planit të veprimit të tij.
4. Grupi ndërinstitucional i punës, sa herë e vlerëson të nevojshme, mund të konsultohet me specialistë të fushës përkatëse nga të gjitha institucionet shtetërore dhe subjektet private në Republikën e Shqipërisë.
5. Grupi ndërinstitucional i punës ka këto përgjegjësi:
 - a) Të hartojë planin e veprimit për të bashkëpunuar dhe koordinuar masat me institucionet qendrore, bashkitë, subjektet, shoqatat dhe agjencitë private, në interes të rishikimit të Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit;
 - b) Të bashkërendojë punën për përgatitjen e Projektplanit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe planit të veprimit të tij;
 - c) Të hartojë Projektplanin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe planin e veprimit të tij, të rishikuar.
6. Grupi ndërinstitucional i punës të mbledhet me njoftimin e kryetarit, në përputhje me kalendarin e takimeve e të veprimtarive. Kryetari i grupit të punës mund të thërrasë mbledhje jashtë radhe sa herë të shihet e domosdoshme.

7. Grupi ndërinstitucional i punës, gjatë ushtrimit të detyrave të parashikuara në pikën 5, të këtij urdhri, të mbështetet nga sekretariati teknik, rolin e të cilit e kryen Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit.
8. Sekretariati teknik ka këto detyra:
- a) Të marrë masat për përgatitjen e kalendarit të takimeve të grupit ndërinstitucional të punës;
 - b) Të sigurojë mbështetjen teknike për zhvillimin e takimeve dhe të proceseve të lidhura me funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës;
 - c) Të koordinojë punën mes institucioneve, të cilat janë pjesë e grupit ndërinstitucional të punës;
 - ç) Të sigurojë përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve të agjendës përkatëse për mbledhjen e grupit ndërinstitucional të punës 5 (pesë) ditë pune përpara takimit.
9. Kalendari i takimeve të përgatitet nga sekretariati teknik dhe kryetari i grupit ndërinstitucional të punës dhe të miratohet me konsensusin e të gjithë anëtarëve para fillimit të takimit.
10. Ngarkohen institucionet dhe strukturat e përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, për dërgimin e emrave të përfaqësuesve të këtij grupi pune pranë Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
11. Ngarkohet grupi ndërinstitucional i punës për përgatitjen e Projektplanit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe planit të veprimit të tij, të rishikuar, brenda 4 (katër) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
12. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, grupi ndërinstitucional i punës dhe sekretariati teknik për mbështetjen e veprimtarisë dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYE MINISTRI

EDI RAMA